



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.Dh.Shk.II.nr.1346/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit KS Besa Security Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “Jusuf Gërvalla”, nr.64, kundër debitorit Auto Center Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “Asllan Pireva”, OB.nr.23, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1218/22 të datës 18.08.2023, me datë 09.02.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pa themeltë ankesa e kreditorit KS Besa Security Sh.P.K., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1218/22 të datës 18.08.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1218/22 të datës 18.08.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar propësimin e debitorit Auto Center Sh.P.K., ashtu që e ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbarimor P.nr.2452/19, të datës 18.12.2019, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Flamur S. Bogaj, sa i përket borxhit në shumën prej 800.00 euro, në pikën II, e ka refuzuar pjesërisht propësimin e debitorit Auto Center Sh.P.K., ashtu që mbetet në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përmbarimor P.nr.2452/19, të datës 18.12.2019, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Flamur S. Bogaj, sa i përket shumës prej 375.00 euro.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori KS Besa Security Sh.P.K., për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit dhe të anulohet aktvendimi e ankimore ose të njëjtin ta rikthej në rishqyrtim.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori KS Besa Security Sh.P.K., me datën 18.12.2019 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit Auto Center Sh.P.K., në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave për shumën e borxhit prej 1,175.00 €.

Përmbartuesi Privat Flamur Bogaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit KS Besa Security Sh.P.K., ka caktuar urdhrin P.nr.2452/19, të datës 18.12.2019, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave nr. 1748-265-001-16 e datës 31.01.2019, nr.3560-265-001-16 e datës 26.02.2016, nr. 5788-265-001-16 e datës 28.03.2016, nr.9570-265-001-16 e datës 28.04.2016, nr. 11889-265-001-16 e datës 24.05.2016, nr.15485-265-001-16 e datës 30.06.2016, nr. 18291-265-001-16 e datës 29.07.2016, nr.21767-265-001-16 e datës 30.08.2016, nr.24263--265-001-16 e datës 30.09.2016, nr.27251--265-001-16 e datës 31.10.2016, nr.31405--265-001-16 e datës 29.11.2016, nr.33425-265-001-16 e datës 28.12.2016, nr.248-265-001-17 e datës 30.01.2017, nr.3261-265-001-17 e datës 27.20.2017, nr.6216-265-001-17 e datës 29.03.2017, nr. 10890-265-001-17 e datës 30.04.2017, nr. 12511-265-001-17 e datës 31.05.2017, nr. 16260-265-001-17 e datës 30.06.2017, nr.18768-265-001-17 e datës 31.07.2017, nr.25263-265-001-17 e datës 29.09.2017, nr.22894-265-001-17 e datës 31.08.2017, nr.27666--265-001-17 e datës 27.10.2017, nr.31363--265-001-17 e datës 30.11.2017, nr.34098-265-001-17 e datës 28.12.2017, nr.2233-265-001-18 e datës 30.01.2018, nr.4846-265-001-18 e datës 28.02.2018, nr. 8673-265-001-18 e datës 30.03.2018, nr. 10965-265-001-18 e datës 30.04.2018, nr.17451- 265-001-18 e datës 30.05.2018, nr.22057-265-001-18 e datës 30.06.2018, nr.24323-265-001- 18 e datës 31.07.2018 dhe nr. 27556-265-001-18 e datës 31.08.2018 nr. 31564-265-001-18 e datës 30.09.2018, nr.35302-265-001-18 e datës 31.10.2018, nr.38850-265-001-18 e datës 30.11.2018, nr.42128-265-001-18 e datës 03.12.2018, nr.905-265-001-19 e datës 04.01.2019, nr. 5920-265-001-19 e datës 02.02.2019, nr. 8596-265-001-19 e datës 01.03.2019, nr.14232- 265-001-19 e datës 01.04.2019, nr.17366-265-001-19 e datës 02.05.2019, nr.22625-265-001-19 e datës 03.06.2019, nr.26533-265-001-19 e datës 01.07.2019, nr. 29139-265-001-19 e datës 01.08.2019, nr.33112-265-001-19 e datës 02.09.2019, nr.36500-265-001-19 e datës 01.10.2019 dhe nr.39183-265-001-19 e datës

01.11.2019, duke urdhëruar debitorin t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 1,175.00€, me kamatë ligjore prej 8% prej ditës kur është bërë kërkesa e arritshme si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore duke përfshirë edhe shpenzimet e avokatit sipas rregullores për Tarifën e Avokatëve, nën kërcënimin të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbartimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbartimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1218/22 të datës 18.08.2023, me të cilin në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Auto Center Sh.P.K., ashtu që e ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbartimor P.nr.2452/19, të datës 18.12.2019, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj, sa i përket borxhit në shumën prej 800.00 euro, në pikën II, e ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Auto Center Sh.P.K., ashtu që mbetet në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përmbartimor P.nr.2452/19, të datës 18.12.2019, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj, sa i përket shumës prej 375.00 euro.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret – në pikën I, sipas Faturave nr.1748-265-001-16 e datës 31.01.2019, nr.3560-265-001-16 e datës 26.02.2016, nr. 5788-265-001-16 e datës 28.03.2016, nr.9570-265-001-16 e datës 28.04.2016, nr. 11889-265-001-16 e datës 24.05.2016, nr.15485-265-001-16 e datës 30.06.2016, nr. 18291-265-001-16 e datës 29.07.2016, nr.21767-265-001-16 e datës 30.08.2016, nr.24263--265-001-16 e datës 30.09.2016, nr.27251--265-001-16 e datës 31.10.2016, nr.31405--265-001-16 e datës 29.11.2016, nr.33425-265-001-16 e datës 28.12.2016, nr.248-265-001-17 e datës 30.01.2017, nr.3261-265-001-17 e datës 27.20.2017, nr.6216-265-001-17 e datës 29.03.2017, nr. 10890-265-001-17 e datës 30.04.2017, nr. 12511-265-001-17 e datës 31.05.2017, nr. 16260-265-001-17 e datës 30.06.2017, nr.18768-265-001-17 e datës 31.07.2017, nr.25263-265-001-17 e datës 29.09.2017, nr.22894-265-001-17 e datës 31.08.2017, nr.27666--265-001-17 e datës 27.10.2017, nr.31363--265-001-17 e datës 30.11.2017, nr.34098-265-001-17 e datës 28.12.2017, nr.2233-265-001-18 e datës 30.01.2018, nr.4846-265-001-18 e datës 28.02.2018,

nr. 8673-265-001-18 e datës 30.03.2018, nr. 10965-265-001-18 e datës 30.04.2018, nr.17451-265-001-18 e datës 30.05.2018, nr.22057-265-001-18 e datës 30.06.2018, nr.24323-265-001-18 e datës 31.07.2018 dhe nr. 27556-265-001-18 e datës 31.08.2018, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarrim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 par.3 të LPP-së. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë dokumenti – Faturave , në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se këto fatura në rastin konkret nuk përmbajnë nënshkrimin apo vulën e debitorit, rrjedhimisht të njëjtat rezultojnë të mos jenë pranuar asnjëher nga debitorit. Në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi urdhrin e përmbarruesit privat P.nr.2452/19 të datës 18.12.2019, për pjesën tjetër të detyrimit në shumë prej 475.00 € për faktin se dokumenti i besueshëm - Fatura nr. 31564-265-001-18 e datës 30.09.2018, nr.35302-265-001-18 e datës 31.10.2018, nr.38850-265-001-18 e datës 30.11.2018, nr.42128-265-001-18 e datës 03.12.2018, nr.905-265-001-19 e datës 04.01.2019, nr. 5920-265-001-19 e datës 02.02.2019, nr. 8596-265-001-19 e datës 01.03.2019, nr.14232- 265-001-19 e datës 01.04.2019, nr.17366-265-001-19 e datës 02.05.2019, nr.22625-265-001-19 e datës 03.06.2019, nr.26533-265-001-19 e datës 01.07.2019, nr. 29139-265-001-19 e datës 01.08.2019, nr.33112-265-001-19 e datës 02.09.2019, nr.36500-265-001-19 e datës 01.10.2019 dhe nr.39183-265-001-19 e datës 01.11.2019, pasi që urdhri i lejuar nga ana e Përmbarruesit Privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht faturave të lartcekura të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë për përmbarrim ngase borxhi që rrjedh nga këto fatura nuk kontestohet nga debitorit andaj rezultojnë se debitorit është i njoftuar dhe është pajtuar me detyrimet që burojnë nga këto fatura dhe shtuar faktin që këto fatura burojnë nga kontrata e datës 07.09.2018 e lidhur mes kreditorit dhe debitorit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore me

rastin e vendosjes për aprovim të pjesshëm të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar si në pikën I të dispozitivit, ku Faturat e lartë cekura nuk janë pranuar nga debitorit dhe mungon nënshkrimi i tij. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par. 3i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Gjithashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë dhe saktë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se në pikën, II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhërin përmbartimor, për dokumenti i besueshëm në faturat e lartëcekura, në shumën e përgjithshme prej 375.00 euro, pasi që këto fatura të lartëcekura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së ku përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, pra janë treguar palët, mallrat/ shërbimet që janë objekt i këtyre faturave. Gjithashtu këto fatura burojnë nga kontrata e lidhur me datën 07.09.2018 të rregullt që është vërtetuar edhe me mos kontestimit të debitorit ndaj këtyre detyrimeve që janë prezente në këto fatura.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se Dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se faturat si dokumente të besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se disa fatura nuk janë pranuar nga debitorit dhe janë të një anëshme, për të cilin është ndër kushtet esenciale mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbartueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Sa i përket faturave tjera që janë të lartëcekura si në pikën II, ato përmbajnë të gjitha tiparet nga dispozitat e LPP-së, pasi që janë prezantuar me kontrat ku janë të pa kontestuar edhe nga debitori për detyrimin që rrjedh prej tyre.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë duke shqyrtuar pretendimet ankimore të kreditorit, vlerësojnë se janë tërësisht të paqëndrueshme pretendimet e kreditorit ku ka theksuar se të gjithë faturat i përmbajnë tiparet e dokumentit të besueshëm ashtu siç është paraparë me nenin 29 par. 1.3 të LPP-së, mirëpo qëndron fakti se disa prej tyre nuk janë kontestuar nga vet debitori ngase nuk janë të nënshkruar nga debitori, andaj edhe për këtë është vendosur si në

dispozitivit të gjykatës shkallës së parë, ndërsa për pjesën tjetër të faturave të cilat edhe ato rezultojn të panënshkrur nga debitori por pavërsisht kësaj debitori për këto fatura me të cilën është vendos si në dispozitën e II të aktvendimit të ankimuar nuk i ka kontestuar andaj rezulton si dokumente të besueshme pasi që debitori është pajtuar me detyrimet që burojnë nga këto fatura, e për më tepër këto fatura burojnë nga kontrata e lidhur në mesë palëve në procedurë e datës 07.09.2018 dhe secila faturë përmbanë shumën ashtu siç është kontraktuar mesë palëve në procedurë dhe të lëshuara brenda periudhës kohore sa ka qenë në fuqi kontrata e lartëcekur, po ashtu kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendimet tjera ankimore por nuk kishin ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarimore.

Kështu, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbarimore organi përmbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshatshmërinë e dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me vërtetimin të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e shkallës së dytë**

K.Dh.Shk.II.nr.1346/23 dt.09.02.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija  
Ymeri.